



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.3197/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Blaca-Dula, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.P., nga fshati ..., Obiliq, të cilin e përfaqëson me autorizim av. J.O. nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK) në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim F.SH., për kompensim të pagës jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3846/18, i datës 30.04.2019, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 12.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e paditësit M.P., nga fshati ..., Obiliq, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3846/18, i datës 30.04.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar numër, C.nr.3846/18, i datës 30.04.2019, ka vendosur:

“I. Refuzohet e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit M.P. nga Obiliqi me të cilën ka kërkuar që “Detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në Prishtinë, që paditësit në emër të pagave për shpërblim jubilar t’ia paguaj shumën prej 2.426.04 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë e bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë si të bazuar ankesën e paditësit dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë duke e aprovuar tërësisht kërkesëpadinë e paditësit.

Ankesa e të paditurës i është dorëzuar të paditurës për përgjigje, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi M.P. nga Obiliqi, me datë 26.12.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës Korporata Energetike e Kosovës – (KEK), sh.a në Prishtinë, ashtu që edhe gjatë seancës për shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, t’ia paguajë tri paga në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 2.426.04 Euro, me kamatë prej 8%, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë si dhe në të njëjtin afat të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të çështjes dhe mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3846/18 i datës 30.04.2019, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar ka theksuar se nga provat e administruara, gjykata gjeti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura për më shumë se 39 vite, të njëjtit nuk i kanë paguar pagesat për shpërblim jubilar në vlerë të tre pagave bazë, të parapara me nenin 52 par. 1.3 të MPKK. Mos pagesën e këtyre pagave edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor e pohoi e paditura, e cila ka pohuar se të njëjtat nuk i takojnë. Lartësinë e pagave mujore në shumë prej 808.68 €, kurse për tre muaj 2.426.04 € gjykata e shkallës së parë e vërtetoi nga lista e pagesës së punëtorit, e që paditësi kishte pranuar pagë mujore në këtë shumë, pra pagesa e fundit neto e pranuar nga paditësi është vlera 808.68 €. Për gjykatën e shkallës së parë kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta është refuzuar, ngase është përfshirë në parashkrim, referuar Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e cila ka pasur shtrirje kohore të zbatimit deri më 31.12.2017, bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të punës dhe nenit 357 të Ligjit Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ndërsa për shpenzimet e procedurës është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkallje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Aktgjykimi është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e administruara dhe zbatimin e të drejtës materiale.

Është i pabazuar pretendimi ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara drejtë ka vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se ka përvojë pune mbi 39 vite, poashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ngase Gjykata e Apelit, pas ekzaminimit të aktgjykimit të atakuar ka ardhur në përfundim se nga vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është zbatuar edhe drejtë e drejta materiale. Nga kërkesa e paditësit drejtuar të paditurës për të kërkuar pagesën e pagave jubilarë nr.817 i dt. 18.05.2018 në vulë, ndërsa në fund të shkresës paraqitet data 21.12.2018, ndërkaq padinë e ka paraqitur në gjykatë të shkallës së parë me datë 26.12.2018, atëherë rezulton se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë, pasi që bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës parashihet se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.” dhe se bazuar në gjendjen faktike paditësi ka arritur përvojën e punës 30 vjeçare në vitin 2010, mirëpo atëkohë nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, si rrjedhojë e drejta në kërkesë në kuptim material për kompensim të këtyre pagave ka lindur në vitin 2010, por dita e paraqitjes së kërkesës, është koha kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive të Kosovës ka hyrë në fuqi, pra nga data 01.01.2015, kështu që afati i fundit për paraqitjen e kërkesës do të kishte qenë brenda periudhës tri vjeçare, që i bie data deri më 31.12.2017. Gjithashtu duke u bazuar në nenin 357 par. 1 i LMD-së, në të cilin citohet se “Kërkesa për shpërbllim të dëmit të shkaktuar parashkruhet për 3 vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dënimin për dëmin dhe për personin e cili ka shkaktuar dëmin”, i bie se këtu paditësit me hyrjen në fuqi të MPKK datë 01.01.2015 iu është njohur e drejta për të paraqitur kërkesën e tij, andaj si datë e fundit do të kishte qenë data 31.12.2017, që nënkupton se ushtrimi i padisë në gjykatë nga ana e paditësit në dhjetor të 2018 rezulton se ka kaluar afati i paraparë ligjor dhe se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar.

Gjykata i mori për bazë të gjitha pretendimet ankimore të paditësit por të cilat nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3197/2020, me datë 12.01.2021

Kryetarja e kolegjit
Nora Blaca-Dula, d.v